



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 01.02.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 30.01.2024 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **A&A&D-Kosova SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **Ritender - "Furnizim me produkte specifike për sëmundje te rralla nga LE"** me nr. prokurimi 206-24-127-1-1-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Aprovohet**, si e bazuar kerkesa per rishqyrtim e OE **A&A&D-Kosova SH.P.K.**, e datës 30.01.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Ritender - "Furnizim me produkte specifike për sëmundje te rralla nga LE"** me nr. prokurimi 206-24-127-1-1-1, kundër Njoftimit për Kontrate, të datës 12.01.2024 te publikuar ne platformën elektronike;
- II. Autoriteti Kontraktues, do te shtyje afatin per ofertim;
- III. Autoriteti Kontraktues, pas njoftimit per korrigjim do te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik **A&A&D-Kosova SH.P.K.**, me datë 30.01.2024 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ritender - "Furnizim me produkte specifike për sëmundje te rralla nga LE"** me nr. prokurimi 206-24-127-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 01.02.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

- LPP
- Neni 21 te RRUOPP
- Afatet kohore

Pretendimi ankimor

Duke pasur parasysh afatin kohor te paraqitur ne DT nga Ministria e Shëndetësisë mendojmë se afatet kohore duhet te jete me i gjata duke vlerësuar DT qe është vlere e madhe andaj kërkojmë ne si OE qe te na mundësohet zgjatja e afatit kohor, sepse për shkak te pushimeve dimërore dhe festave ende skemi pranuar dokumentacionin final nga partneret tanë.

Po ashtu duke pare kompleksitetin e produkteve qe janë te dedikuar për sëmundje te rralla "Orphane" kërkojmë mirëkuptimin tuaj dhe mire presim një përgjigje pozitive.

Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Pajtohem me pretendimin e OE ankues, afati per ofertim dhe hapje te ofertave shtyhet per daten 16.02.2024 deri ne ora 14:00.


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato qe u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. A&A&D-Kosova SH.P.K.
2. Operatoreve ekonomik te interesuar



Berat Marmullaku
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit